

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Dollap për dosje 90 x 45 x 210h cm (e njëjta gjë dhe për përmasën 80 x 45 x 210h)

- Struktura me panele prej materiali lëndë drusore, me perimetër të rrethuar me material PVC me të njëjtën ngjyrë e me trashësi 2 mm.
- Dollapi duhet të ketë 5 ndarje horizontale. Kanatat në pjesën e poshtme të pajisen me çelës. Materiali i përdorur për këtë objekt të jetë rezistent ndaj gërvishtjeve dhe lagështirës.
- **Kanatat prej xhami.** Kapaket e raftit janë të pajisura me dyer xhami 5 mm i temperuar me kornizë dhe mentesha.
- **Ngjyra e dollapit:** Do të përzgjidhet nga porositësi.
- **Ngjyra e xhamit:** Do të përzgjidhet nga porositësi.

Tavolinë 150 x 60 + 90 x 50 x 75h me sirtare

Tavolina me material lëndë drusore, me trashësi 25 mm e plastifikuar me PVC. Sipërfaqja do të ndërtohet nga dy pjesë të cilat duke u bashkuar formojnë formën L të tavolinës. Sipërfaqja do të mbahet nga melaminë me material të njëjtë si Sipërfaqja. Këmbët e tavolinës do të lidhen me njëra-tjetrën me një lidhëse e cila duhet të jetë 37 cm e shkëputur nga toka. Materiali i përdorur për këtë objekt të jetë rezistent ndaj gërvishtjeve, njollave, lagështirës.

- **Ngjyra e Tavolinës-** Do të përzgjidhet nga porositësi.

Sirtarët e tavolinave 150x60+90 x 50 x 75h: Përmasat janë 45 cm x 50 cm x 60 cm. Struktura e sirtarëve është e përberë nga material mdf me spesor 18 mm e plastifikuar me PVC 2mm. Struktura e sirtarëve është me 3 ndarje të barabarta me mbyllje me çelës. Sirtarët duhet të rrëshqasin mbi shina metalike me rrota. Në pjesën e poshtme të saj vendosen 4 rrota që kryejnë funksionin lëvizës.

Tavolina 140 x 60 x 75h, 120 x 60 x 75h, 110 x 60 x 75

Tavolinat me material lëndë drusore, me trashësi 25 mm e plastifikuar me PVC. Sipërfaqja do të ndërtohet nga dy pjesë të cilat duke u bashkuar formojnë formën L të tavolinës. Sipërfaqja do të mbahet nga melaminë me material të njëjtë si Sipërfaqja. Këmbët e tavolinës do të lidhen me njëra-tjetrën me një lidhëse e cila duhet të jetë 37 cm e shkëputur nga toka. Materiali i përdorur për këtë objekt të jetë rezistent ndaj gërvishtjeve, lagështirës. Në pjesën e poshtme të sipërfaqes do të ketë të inkorporuar sirtare me çelës.

- **Ngjyra e Tavolinës**- Do të përzgjidhet nga porositësi.

Tavolina 220 x 80 + 50 x 160 x 75 h

Materiali të jetë MDF me rezistencë ndaj gërvishtjeve. Trashësia minimale e sipërfaqes 50 mm. Sipërfaqja mbështetet nga njëra anë mbi një sipërfaqe anësore me të njëjtat karakteristika si sipërfaqja. Struktura e zgjatimit është prej MDF. Tavolina do të jetë e pajisur me ballore prej MDF.

Sirtari

Përmasat janë 45 cm x 50 cm x 60 cm. Struktura e sirtarëve është e përberë nga material md f me spesor 18 mm e plastifikuar me PVC 2mm. Struktura e sirtarëve është me 3 ndarje te barabarta me mbyllje me çelës. Sirtarët duhet të rrëshqasin mbi shina metalike me rrota. Në pjesën e poshtme të saj vendosen 4 rrota që kryejnë funksionin lëvizës.

- **Ngjyra** - Do të përzgjidhet nga porositësi

Recepti ne forme banaku 230 x 110 h + 230 x 70 x 75h

Pjesa ballore e banakut do jetë me lartësi 110 cm e përbërë nga dy pjesë.

Sipërfaqja e banakut duhet të ketë gjerësi 40 cm dhe trashësi 36 mm, me PVC 2 mm.

Materiali i përdorur për këtë objekt duhet të jete rezistent ndaj gërvishtjeve dhe lagështirës i përbërë nga lëndë drusore me trashësi 25 mm e plastifikuar me pvc. Këmbët e tavolinës do të lidhen me njëra-tjetrën me një lidhese e cila duhet të jetë 37 cm e shkëputur nga toka. Materiali i përdorur për këtë objekt të jetë rezistent ndaj gërvishtjeve, lagështirës.

- **Ngjyra** - Do të përzgjidhet nga porositësi

Sirtarët

Përmasat janë 45 cm x 50 cm x 60 cm. Struktura e sirtarëve është e përberë nga material md f me spesor 18 mm e plastifikuar me PVC 2mm. Struktura e sirtarëve është me 3 ndarje të barabarta me mbyllje me çelës. Sirtarët duhet të rrëshqasin mbi shina metalike me rrota. Në pjesën e poshtme të saj vendosen 4 rrota që kryejnë funksionin lëvizës.

Kredenca 320 x 50 x 120h

Struktura duhet të jetë e ndërtuar me panele prej materiali lëndë drusore me perimetër të rrethuar me material MDF të së njëjtës ngjyrë me atë të sipërfaqes me Spesor 25 mm. Pjesët e sipërme duhet të mbulohen në anët e gjata.

Kanatat prej xhami

Rafti është i pajisur me dyer xhami me çelës dhe xham të temperuar jotransparent me trashësi 5 mm.

Kanatat prej lënde drusore

Kanatat janë prej lënde drusore me material MDF me spesor jo më pak 18 mm.

- **Ngjyra e dollapit:** Do të përzgjidhet nga porositësi.
- **Ngjyra e xhamit:** Do të përzgjidhet nga porositësi.

Tavolin Mesi 80 x 80 x 45h

Struktura duhet të jetë e ndërtuar me panele prej materiali lëndë drusore me perimetër të rrethuar me material MDF të së njëjtës ngjyrë me atë të sipërfaqes me Spesor 25 mm.

Sipërfaqja e tavolinës të ketë ndërthurje me element të tjerë si xhami dhe alumini.

- **Ngjyra:** Do të përzgjidhet nga porositësi.

Kolltuk 2 vendesh 140 x 65 x 75h

Kolltuku dysh të jetë i përbërë me lekure të zezë, ndenjësen, krahët dhe shpinoren të jenë të përbëra me dru, këmbët të jenë të përbëra me tuba cilindrik metalik 40 mm dhe trashësia e metalit 2 mm.

- **Ngjyra:** Do të përzgjidhet nga porositësi

Karrige Rrotulluse

Karriget rrotulluese duhet të jetë prej lekure. Ngjyra sipas kërkesës së blerësit. Shpinorja e poltronës duhet të jetë e lartë jo më pak se 80 cm.

Poltronat duhet të jenë pajisur me mekanizëm për ulje ngritje. Krahët e poltronës duhet të jenë prej metali të kromuar dhe të veshura me lëkure, me ngjyrë të njëjtë si poltrona.

- **Ngjyra:** Do të përzgjidhet nga porositësi

Shtojca 10

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr	Pershkrimi i Punimeve	Njesia	Sasia	Cmimi /njesi	Cmimi total
1	Tavoline pune 150 x 60 + 90 x 50 x 75 h	COPE	4		
2	Tavoline pune 140 x 60 x 75 h	COPE	3		
3	Tavoline pune 120 x 60 x 75 h	COPE	24		
4	Tavoline pune 110 x 60 x 75 h	COPE	2		
5	Dollap dosjesh 90 x 45 x 220 h	COPE	6		
6	Dollap dosjesh 80 x 45 x 220 h	COPE	5		
7	Recepsioni ne forme banaku	COPE	1		
8	Tavolina Pune 220 x 80 + 50 x 160 x 75 h	COPE	1		
9	Kredence	COPE	1		
10	Tavolin Mesi	COPE	1		
11	Kolltuk 2 vendesh	COPE	2		
12	Karrige Rrotulluse	COPE	1		

*cmimet jane pa TVSH.

Afatet e lëvrimit: 20 dite nga nenshkrimi i kontrates.

Procurement
Albania